

# RAPORT TEKNIK

## **OBJEKTI:**

**RRETHIM DHE SISTEMIM I VARREZAVE TE QYTETIT DHE  
NDERTIM BAZAMENTE MBESHTETESE DHE SHPATULLA TE  
URES FSHATI STOJAN, BASHKIA MAT**

**PROJEKTUESI**

"TRIANGLE" sh.p.k

Ing. Zenulla MEHMETI

## 1. HYRJE

Ne kete relacion teknik do te trajtohen problematikat dhe zgjidhja teknike lidhur me punimet per Rrethim dhe sistemim i varrezave te qytetit si dhe ndertimin e bazamentev mbeshtetese dhe shpatullave te ures se fshatit Stojan ne bashkine Mat.

Sa i perket varrezave te qytetit eshte bashkia nje pjese e territorit te varrezave te cilin bashkia e ka ne pronesi eshte e pa mbrojtur si dhe e pa sistemuar. Nepermjet kesaj nderhyrje bashkia synon te siguroje ato duke ndertuar nje rrethim mbrojttes si dhe ne planifikimet e saj te ardhshme edhe nderhyrjet lidhur me sistemimet e bendshme. Parcela e cila do te rrethohet ndodhet ne zonen kadastrale Nr. 1325 dhe mban numer pasurie 638/6. Siperfaqja totale e prones qe do te rrethohet eshte 4156 m<sup>2</sup>.

Siç shihet ne figuren e meposhtme prona lokalizohet ngjitur me varrezat ekzistuese, dhe ne kete



kontekst eshte parashikuar qe rrethimi i objektit te behete vete ne tre drejtimet e tij respektivisht Veri, Jug dhe Perendim te saj duke iu bashkengjitur rrethimit te varrezave ekzistuese.

Rrethimi eshte parashikuar te ndertohet me themele dhe mur prej betoni per nje lartesi qe do te varioje deri ne 0.5 m dhe mbi te do te instalohen konstruksione metalike SHS 75x2.8 mm te vendosura cdo 2 meter te cilat do te sherbejne per te instaluar ne te rrjeten e telit te zinkuar me kuadrate 2x2 cm. Gjatesia totale e rrethimit eshte rreth 206 ml dhe lartesia totale e tij eshte 1.7 m nga te cilat 1.2 eshte lartesia e rrjetes mbrojttese.

Gjithashtu eshte parashikuar te instalohet edhe nje porte hyrese per ne varreza. Porta hyrese do te jete me dy hapje dhe do te kete permasa 4 x 1.6m. Te dhena teknike dhe detajet e realizimit te objekti jepen ne vizatimet pjese e ketij projekti.

Projekti tjetër të cilin do të trajtojmë në këtë relacion lidhet me ndërtimin e bazamentit dhe të shpatullave të Urës mbi zallin e fshatit Stojan, Njësia Administrative Baz. Kalimi ekzistues është me 2 cope tombino 1200mm të cilat nuk e përballojnë të gjithë sasinë e ujit gjatë reshjeve të dimrit. Bazamentet dhe shpatullat do të behen nga fillimi ndërsa për urë do të përdoret konstrukcioni metalik i cili është hequr nga ura e vjetër mbi prroin Hotaj. Pasi mbi të është parashikuar të vendoset ura metalik e cila ka qene e vendosur mbi prroin. Ura është e ndërtuar mbi ujrat e përroit Hotaj me gjatësi 18 m, në fshatin Stojan të Njesisë Administrative Ulëz dhe lidh fshatin Stojan me Bashkinë Mat dhe me rrugën nacionale Tiranë-Peshkopi. Gjithashtu do u shërbente banorëve të fshatit për të patur një akses më të shpejtë në qendrën shëndetsore dhe në shkollën e fshatit..

Foto të gjendjes ekzistuese





## Horografia e ures



## 2. DETYRA E PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit kërkon të hartohet projekti për: **“Ndertim bazamente mbeshtetese dhe shpatulla, te ures fshati Derjan dhe te ures fshati Stojan, Mat”**

Projekti i zbatimit te hartohet sipas kushteve teknike te projektimit duke marrë në konsideratë të dhënat e mësipërme.

Projekti i zbatimit duhet të paraqesë:

- a. Planimetrinë, profil gjatësor dhe profila terthorë.
- b. Relacionin teknik
- c. Preventivin e punimeve
- d. Grafikon e punimeve
- e. Specifikimet teknike

### 3. RELACIONI TOPOGRAFIK

Matjet topografike u kryen duke u mbështetur ne rrjëtin shteteror koordinativ, duke iu përshtatur kërkesave të dhëna në termat e referencës.

Saktësia e realizuar në matje me GPS-in tonë është +- 1 cm në plan dhe + 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit. Grupi i topografeve u shoqërua nga inxhinieret hidroteknike dhe inxhinieri gjeolog. Pas përfundimit të matjeve në terren u bë përpunimi i matjeve topografike dhe hartimi i dokumentacionit të duhur.

### 4. PROJEKTI I ZBATIMIT

Për ndërtimin e objektit " Ndertim bazamente mbeshtetese dhe shpatulla, te ures fshati Derjan dhe te ures fshati Stojan, Mat ", projekti parashikon të përdoren materiale të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe të zbatohen me rigorozitet Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve. Gërmimet janë parashikuar të kryhen me makineri edhe në prani të ujit si për bazamentin si për shaptullat e urës.

Betonet janë parashikuar të prodhohen me betoniere në vend por edhe mund te merren tek fabrikat e betonit si beton me i garantuar.

Gjatë ndërtimit të këtij objekti të kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Betonet janë parashikuar të jenë të markës C 30/37
- 2.-Te gjitha betonet janë parashikuar të formohen me betonforma.
- 3.- Nuk do të hidhet beton pa përdorur vibratorin, qoftë atë të thellesisë apo atë sipërfaqesor. Materialet e objektit do të merren nëprodhuesit që plotesojnë kërkesat e specifikimeve teknike. Materialet inerte për betonet do të merren në nyjet e fraksionimit që ndodhen në afërsi të zonës.
- 4.- Do të përdoret hekur beton i zakonshëm i viaskuar

### **PERGATITI**

**"TRIANGLE" sh.p.k**

Ing. Zenulla MEHMETI